



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 23 maj, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese zgjodhi sërish gjykatësin Vidar Stensland si kryegjykatës për një mandat njëvjeçar, sikurse përcaktohet në Rregulloren e Procedurës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e Kosovës thotë se Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese përbëhet prej tre gjykatësve ndërkombëtarë dhe vendos ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese lidhur me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Hagë vepron si mekanizëm mbrojtës i të drejtave të njeriut. Personat e akuzuar dhe viktimat mund t'i paraqesin kërkesa referuese këtij paneli të pavarur gjykatësish në lidhje me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara nga Kushtetuta, pasi të kenë shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e tjerë të mundshëm të apelit. Dhoma e Specializuar ka lëshuar disa vendime publike mbi kërkesa referuese të personave të akuzuar, të cilat mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së, së bashku me arsyetimin e gjykatësve për secilin rast.

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka rishikuar gjithashtu Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të DHS-së që zbatojnë trupat gjykues, për të siguruar që rregullat përmbushin të gjitha standardet e të drejtave të njeriut që garanton Kushtetuta e Kosovës.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 15 maj, Trupi Gjykues hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes për të rishqyrtuar pranimin si provë të një deklarate dëshmitari vetëm me shkrim. Trupi Gjykues konstatoi se Mbrojtja nuk kishte vërtetuar që Trupi Gjykues bëri gabim të qartë në arsyetim kur e pranoi atë provë.

Trupi Gjykues konstatoi gjithashtu se Mbrojtja kishte keqinterpretuar vendimin për pranimin e deklaratës vetëm me shkrim, kur argumentoi se prova ishte pranuar bazuar në premisën se dëshmitari do të ishte në dispozicion për t'u marrë në pyetje nga pala kundërshtare. Trupi Gjykues





rikujtoi se në vendimin e tij konstatoi se çdo kufizim në marrjen në pyetje nga pala kundërshtare do të merret parasysh nga Trupi Gjykses gjatë vlerësimit të peshës dhe vlerës provuese të provave.

Më 27 maj, në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses vendosi mbi një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar prova në lidhje me dëshminë e një dëshmitari ekspert. Gjykatësit miratuan pjesërisht kërkesën, por nuk pranuan si prova disa pjesë të materialit burimor që lidhej me aktekspertizën e dëshmitarit.

Po atë ditë, në një vendim tjetër, gjykatësit pranuan disa prova të propozuara nga Prokuroria në lidhje me dëshminë e një dëshmitari tjetër ekspert, si dhe dy dokumente që u kërkuar të pranoheshin si prova nga Mbrojtja e z. Veseli dhe e z. Krasniqi në lidhje me dëshminë e ekspertit. Trupi Gjykses udhëzoi më tej Prokurorinë që dorëzonte versionin e redaktuar publik të aktekspertizës.

Më 28 maj, mbrojtësi i viktimave në këtë çështje gjyqësore bëri të ditur se do të jetë gati të paraqesë prova në gjykim gjatë javëve që fillojnë më 7 dhe 14 korrik, në varësi të rezultatit të ndonjë vendimi të Trupit Gjykses mbi mocionet e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të akuzave. Mbrojtësi i viktimave kërkoi të thërrasë dy ekspertë që kanë përpiluar një raport mbi dëmin e pësuar nga viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore. Ai kërkoi gjithashtu që të pranohen dëshmitë me shkrim të gjashtë viktimave pjesëmarrëse dhe një numër materialesh provuese.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit, më 27 maj, Paneli i Apelit miratoi një kërkesë të Prokurorisë për t'u vënë në dispozicion palëve një numër parashtrimesh në lidhje me apelet e z. Thaçi dhe z. Selimi kundër masave hetimore të posaçme të urdhëruara nga Gjykatësi i Vetëm në vitin 2023. Paneli i Apelit gjithashtu udhëzoi Administratoren që ta riklasifikonte kërkesën e Prokurorisë si publike.

